

Hatixhe Bajrami¹

UDC: 327.51(100-622HATO):342.1(497.115)

341.171(4-672EY):342.1(497.115)

341.123:342.1(497.115)

**NDIKIMI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE NË KRIJIMIN
E SHTETIT TË KOSOVËS**

**ВЛИЈАНИЕТО НА МЕЃУНАРОДНИТЕ ОРГАНИЗАЦИИ ВРЗ
СОЗДАВАЊЕТО НА ДРЖАВАТА КОСОВО**

**THE INFLUENCE OF INTERNATIONAL ORGANIZATIONS ON
THE CREATION OF THE STATE OF KOSOVO**

Abstract

Today, the modern man meets the state every day and is in constant contact and in a mutual relationship with it. The state is generally a phenomenon of the modern era and constitutes the central political institution worldwide. This paper aims to examine the role that international organizations have played and the contribution they have made to the development of the state of Kosovo. After this part, it continues with the concrete benefits and the role played by various international organizations in the development of Kosovo. Where I have selected to analyze the mission of only three of them, namely NATO, the UN, and the EU as the organizations with the most important in this process of the independence of the state of Kosovo.

Keywords: *state, state-building, international organizations, the state of Kosovo*

¹ Studente e ciklit të II-të (magjistraturë) në Shkencat Politike-Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Studime Europiane University of Tetovo, email- hatixhe.bajrami@unite.edu.mk

Hyrje

Shteti përfshin më shumë sesa vetëm të qeverisurit e një vendi dhe të një populli. Shteti paraqet institucion të krijuar nga grupi për ruajtjen e interesave të tij, interesat brenda shtetit dhe në marrëdhëniet ndërshtetërore si dhe duhet t'i ketë këto elemente: popullsinë e përhershme, territorin dhe pushtetin legjitim. Gjithashtu, koncepti mbi shtetin merr kuptime të ndryshme varësisht prej këndvështrimeve e aspekteve që trajtohen dhe nocioni shtet përdoret në trajta të shumta. (Gashi, 2006). Ballkani në përgjithësi, e Ballkani Perëndimor në veçanti, ka qenë arenë e ndeshjeve dhe konflikteve të herëpashershme. Vende ku kanë filluar luftëra botërore dhe kanë shpërthyer konflikte rajonale dhe etnike. (Qirko, 2017). Autorët e së drejtës ndërkombëtare e përkufizojnë shtetin si institucion i krijuar nga grupi për realizimin e disa qëllimeve, prej të cilëve më i rëndësishmi është ruajtja e së drejtës dhe e rendit brenda kufijve dhe ruajtja e pavarësisë së popullit në marrëdhënie me popujt e tjerë, ose si bashkësi që në një hapësirë të caktuar vepron si organizatë më e lartë e rendit juridik që nuk i është nënshtruar asnjë organizate tjetër. (Gruda, 2003) E drejta ndërkombëtare përcakton disa kushte që duhet të plotësohen për t'u paraqitur një shtet e ato janë: popullsia e përhershme, territori ku jeton kjo popullsi dhe pushteti legjitim, që e përfaqëson popullsinë. Pasi shtetet mbajnë marrëdhënie me njëri tjetrin, me paraqitjen e shtetit të ri, paraqitet edhe çështja e vendosjes së marrëdhënieve me këtë shtet ose e thënë ndryshe – njohja e tij. Njohja është një akt deklarativ me të cilën një shtet deklaron se shteti i ri, i ka të gjitha elementet që parasheh me aktet e veta e drejta ndërkombëtare për të qenë shtet. P.sh shtetin më të ri në botë Republikën e Kosovës deri më tash e kanë njohur 117 shtete, të cilat pra deklarojnë se Republika e Kosovës, i plotëson të gjitha kriteret themelore për të qenë shtet siç i cekëm më lartë. Në këto dhe raste tjera nënvizohet se shteti i ri bëhet subjekt i së drejtës ndërkombëtare me plotësimin e tri kushteve themelore që ishin: popullsia e përhershme, territori dhe pushteti legjitim ndërsa njohja e tij është thjesht deklarative dhe vetëm konstatim i gjendjes së krijuar faktike. Si rrjedhim teoria deklarative është teori më e re, më bashkëkohore dhe më shumë i përgjigjet rrethanave të krijuara në të drejtën ndërkombëtare. Përndryshe njohja e shteteve të reja është një akt individual dhe i lirë i shteteve, që e vendosin ta bëjnë secili shtet për vete ose si grup shtetesh duke pasë parasysh interesat e tyre shtetërore. E drejta ndërkombëtare publike njeh disa

lloje të njohjeve, si më të rëndësishme janë: njohja de jure dhe de fakto, njohja shprehimisht apo heshtazi, njohja mund të jetë edhe individualisht apo kolektivisht etj. (Puto A. , 2004).

Krijimi dhe njohja e Republikës së Kosovës

Një nga sfidat më problematike ishte konceptimi i pikënisjes për plotësimin e mozaikut, i cili në vete ngërthen një histori të tërë njerëzore, humanitare, kombëtare dhe ndërkombëtare, me një fjalë tërë procesin e evoluimit të diplomacisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare rreth çështjes së Kosovës, gjatë periudhës 1990-2010, por e cila në vete përfshinë edhe një parahistori të gjatë gjeostrategjike, politike, diplomatike etj.

Që prej momentit të shpërbërjes së Jugosllavisë një sërë parimesh dhe normash që konsiderohen të rëndësishme për ruajtjen e rendit ndërkombëtar dhe paqen rajonale, duket se kanë ndikuar politikatat e ndjekura dhe masat e aplikuara nga diplomacia ndërkombëtare ndaj çështjes dhe më vonë pavarësisë së Kosovës. Dy muaj pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese më 7 shtator 1990, të njëjtët delegatë nxorën aktin më të lartë juridik - Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila edhe formalisht e shpallte Kosovën Republikë. Kosova ishte kryefjala e mediave në 1999, por konflikti ishte i parashikueshëm qysh më vitin 1989. Komuniteti ndërkombëtar nuk arriti të vinte në jetë masa preventive efektive, duke vepruar vetëm pasi kriza shkoi drejt një konflikti të armatosur. Gjatë gjithë vitit 1998, komuniteti ndërkombëtar dështoi në mënyrë të përsëritur në përpjekjet për të arritur një pozicion të unifikuar në zgjidhjen e konfliktit. (Enika Abazi, Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm, 2015)

BE-ja siç duket ka vendosur të respektojë parimin e mosintervenimit në punët e brendshme në lidhje me shtetësinë e Kosovës të shkaktuar nga mosnjohja e Kosovës me motive penguese nga Qiproja, Greqia, Spanja, Sllovakia dhe Rumania. Rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian është e paparashikueshme, sepse pesë anëtarë të BE-së, - Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - nuk e njohin Kosovën si shtet të pavarur. Anëtarësimi i Kosovës në BE kërkon njohje nga pesë jonjohësit.

Shpërthimi i luftës në Kosovë

Lufta e Kosovës ishte një konflikt i armatosur i cili filloi në muajin shkurt të vitit 1998 nga agresioni serb. Më 6 e 7 Mars, Prekazi u rrethua nga policia serbe duke u drejtuar në Kullën e Jasharajve, për ta sulmuar atë me armë të llojeve të ndryshme. Pas një qëndrese titanike nga familja Jashari, pas tri ditë rresht qëndrese bien në altarin e lirisë mbi 50 dëshmorë, shumica prej të cilëve ishin gra dhe fëmijë. Vrasja e familjes Jashari reflektoi thellë, duke prekur ndërgjegjen e gjithë shqiptarëve. Ngjarja në Prekaz shkaktoi një valë të re të shpërnguljeve të refugjatëve nga Drenica në vise të tjera të Kosovës. Në mars të këtij viti, Grupi i Kontaktit (SHBA, Rusi, Francë, Gjermani, Itali) iu kërcënuua Serbisë me një varg masash si p.sh. mos dhënia e vizave, bllokimi i kredive dhe investimeve nëse Millosheviqi nuk e ndryshonte politikën e tij brenda dy javësh. Kur ky afat po skadonte, ai u vazhdua edhe për një muaj. Përgjigjja e vetme e Millosheviqit ishte zgjerimi i sulmeve mbi caqet e UÇK-së nëpër fshatra. Fuqitë e mëdha bënë përsëri përpjekje për të bërë presion mbi pushtetin jugosllav duke kërcënuar me sulme ajrore. Ndërsa, në tetor u arrit një marrëveshje mes emisarit amerikan Richard Holbrook dhe Millosheviqit me disa kushtëzime si p.sh. të zvogëlohej numri i forcave serbe në Kosovë dhe të gjithë shqiptarët të mbeten nëpër shtëpitë e tyre, sigurisht duke qenë nën vëzhgimin e ndërkombëtarëve. Ditët e fillimit të vitit 1999 treguan me fuqinë e fakteve se kishte mbaruar armëpushimi. Pikërisht në këtë periudhë të një gjendjeje “as luftë, as paqe” ndodhi masakra e Reçakut. Në atë kohë në terren ishte e pranishme OSBE, përmes një misioni. Ai ishte krijuar në vitin 1998 me qëllim të kontrollimit të zbatimit të rezolutës 1199 të OKB-së dhe të armëpushimit. Kreu i misionit, William Walker e akuzoi menjëherë Beogradin, pasi e dinte se masakra nuk ishte një “pasojë e pakëndshme” e paraushtarakëve. Çështja e Kosovës u përmend vetëm një herë në tekstin e Marrëveshjes së Dejtonit në lidhje me parakushtet që duhet të plotësoheshin me qëllim heqjen e “embargos së jashtme” (outer wall of sanctions) mbi entitetin që kishte mbetur nga ish Federata Jugosllave, Serbia dhe Mali i Zi. Koncepti i “embargos së jashtme” mbi Jugosllavinë u bë i qartë në Deklaratën e Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara, më 23 nëntor 1995, dy ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes. Ndonëse, në momentin kur u nënshkrua Marrëveshja e Dejtonit në Kosovë nuk kishte luftë, dispozitat e dokumentit të nënshkruar me Milosheviqin krijuan efekte negative në mundësitë e zgjidhjes

së çështjes së Kosovës. (Watch, 2002). Zgjidhjet e nënkuptuara të ofruara në Dejton për serbët dhe shqiptarët e Kosovës e bënë më se të dukshëm paqëndrueshmërinë e modelit unik të bashkëjetesës armiqësore. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Serbia në vazhdimësi është angazhuar në mënyrë aktive për të penguar forcimin e brendshëm dhe konsolidimin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një angazhim i tillë ishte edhe përpjekja e saj për kontestim të shpalljes së pavarësisë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, gjë e cila u hodh poshtë. Megjithatë, opinionin e GJND-së hapi rrugë për nisjen e një procesi të ri të dialogimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që për qëllim kishte zgjidhjen e kontesteve bilaterale, gjë që do të çonte në normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve.

Bisedimet në Rambuje (1998-1999)

Diplomacia parandaluese ishte etapa vijuese, e cila përmbylli përpjekjet e diplomacisë ndërkombëtare për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për çështjen e Kosovës, përpara ndërhyrjes ushtarake të trupave të NATO-s. Në këtë fazë, për herë të parë ndërhyrja e diplomacisë ndërkombëtare ishte specifike pasi ajo u mor në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të hollësishme me palët në konflikt. Udhëzimet apo rekomandimet e diplomacisë ndërkombëtare më parë i kishin trajtuar në mënyrë të diferencuar shqiptarët e Kosovës në krahasim me minoritetet e tjera të ish-Jugosllavisë. Marrëdhëniet konfliktuale të Kosovës me Serbinë pengojnë funksionet kryesore të brendshme dhe të jashtme të shtetit, të cilat përfshijnë qeverisjen demokratike, kohezionin shoqëror dhe integrimi në sistemin ndërkombëtar. Edhe pse diplomacia konsiderohet si është art i bisedimeve ose praktika e realizimit të marrëdhënieve ndërkombëtare nëpërmjet negociatave, traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Në rastin e Kosovës kishte tendenca të shumta nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare për të stabilizuar situatën por përsëri si përfundim konflikti i armatosur ishte i pashmangshëm. (Enika Abazi, Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm, 2015)

Ndikimi i organizatava ndërkombëtare në krijimin e shtetit të Kosovës

Dihet se nevoja e bashkëpunimit, zgjerimi dhe intensifikimi i lidhjeve mes shteteve, shtimi i ndërvarësisë mes tyre ka sjellë krijimin e organizatave ndërkombëtare. Ajo çka është e rëndësishme për t'u përmendur janë rolet dhe funksionet e organizatave ndërkombëtare: ato ekzistojnë me objektiva të ndryshme, duke nxitur arsimin, kujdesin shëndetësor, zhvillimi ekonomik, mbrojtjen e mjedisit, të drejtat e njeriut, përpjekjet humanitare, bashkëpunimin, vendosjen e normave dhe parimeve midis shteteve anëtare, kontakte ndërkulturore dhe zgjidhjen e konflikteve. Gjithashtu organizatat ndërkombëtare janë bashkësi e përhershme me karakter qeveritar ose joqeveritar të krijuar mbi bazë të një marrëveshje ndërkombëtare me qëllim bashkëpunimi në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të parashikuara në ato dokumente. Nga ky përkufizim del që organizatat ndërkombëtare krijohen me vullnetin e shteteve, pra themelues te organizatave ndërkombëtare janë shtetet sovrane në rastin kur organizatat janë shtetërore dhe ato krijohen bazuar në një traktat ndërkombëtar. (Dalipi, 2022)

Prandaj, organizatat ndërkombëtare janë arena të forumeve brenda të cilave zhvillohen negociata të ndryshme paqësore. Në këtë rast organizatat ndërkombëtare u ofrojnë vendtakime anëtarëve të vet për t'u bashkuar dhe diskutuar, bashkëpunuar e në shumicën e rasteve për t'u mos pajtuar për ndonjë çështje të caktuar. Gjatë këtyre bisedimeve të shteteve anëtare në këto forume apo arena, e tërë bota pret me padurim rezultatin e këtyre bisedimeve siç kemi rastin me konfliktin Rusi-Ukrainë, që për fat të keq është konflikti më i ashpër gjeopolitik për momentin dhe si duket do të sjellë pasoja shumë më të mëdha globale, por që për vendet e Ballkanit Perëndimor ndoshta mund të përshpejtojë procesin e aderimit në BE, ku edhe pse janë bërë hapa të mëdha, përparime, por përsëri duket se do të ketë edhe shumë punë në këtë aspekt. Gjithashtu dy shtetet fqinje Kosova dhe Serbia pas shumë negociatave që janë zhvilluar në Bruksel mes të dërguarit të BE-së Josep Borell, është kuptuar se nuk kanë alternativë tjetër përveç se të arrijnë marrëveshje finale për normalizim marrëdhëniesh mes tyre e cila do t'i shtrojnë rrugën Kosovës drejt anëtarësimit apo përafrimit të saj me organizatat e mekanizmat kryesorë sot në botë. Këto bisedime zgjasin varësisht edhe prej çështjes e cila është në fokus të bisedimeve.

Të gjithë jemi dëshmitarë, për fat të keq, të tendencave qofshin direkte ose indirekte të shteteve me fuqi të mëdha për të mbizotëruar nëpër vendet më të vogla ku kanë interesa ekonomike apo gjeopolitike, andaj ne duhet të mësojmë nga historia jonë dhe të mos lejojmë të përsërisim gabimet tona, të mos jemi pre e kërcënimeve dhe rreziqeve për të siguruar rrugën e së ardhmes. Ne i kemi parë të dy anët e monedhës siç thuhet në rastet e organizatave ndërkombëtare ose Evropës në përgjithësi, ne e shohim se si Evropa është e shurdhër për sulmet dhe krimet që po kryhen në Lindjen e Mesme ku edhe pse thuhet se BE-ja po financon palestinezët, por mendoj se kjo organizatë duhet të merr më seriozisht rolin e saj si ndërmjetësues për të ndaluar konfliktet e armatosura të arrihet armëpushimi me plotëkuptimin e fjalës dhe të fillojnë bisedimet për paqe për këtë popull që po vuan me dekada.

Roli i NATO-s në pavarësinë e Kosovës

Fushata e bombardimeve ajrore të NATO-s zgjati nga 22 mars deri 11 qershor 1999, ku u përfshinë diku rreth 1.000 avionë që kane operuar kryesisht nga bazat në Itali dhe nga anijet detare luftarake dhe transportuese avionësh të vendosur në Detin Adriatik. Të gjithë anëtarët e NATO-s kanë qenë të përfshirë në një farë mase në këtë intervenim të NATO-s, edhe Greqia, pavarësisht kundërshtimit të saj publik ndaj këtyre sulmeve. Fushata e NATO-s fillimisht ishte projektuar për të shkatërruar mbrojtjen ajrore jugosllave dhe objekteve të mëdha ushtarake. Në të njëjtën kohë, negociatorët finlandezë dhe rusë vazhduan në përpjekje për të bindur Millosheviqin të tërhiqet. I ballafaquar me situatë të pavolitshme Millosheviqit nuk i kishte mbetur tjetër veç se të pranojë kushtet e ofruara nga një ekip ndërmjetësish finlandezo-rusë dhe ranë dakord për një prani ushtarake në Kosovë e kryesuar nga OKB-ja, por duke përfshirë trupat e NATO-s. Dakordimi u arrit me marrëveshjen e Kumanovës më 9 qershor 1999 ose siç quhet edhe ndryshe Marrëveshja Tekniko-Ushtarake, e cila mes të tjerave parashihte ndërprerjen e luftimeve në mes forcave të NATO-s dhe atyre ushtarake, lejimin e futjes ndërkombëtare që udhëhiqej nga misioni i OKB-së dhe forcat e NATO-s, që do të mbronin kufirin e Kosovës, pranimin e marrëveshjes dhe miratimin e saj në parlamentin jugosllav, demilitarizimin e UÇK-së, etj. (Bislimi, 2010) Shqiptarët u janë mirënjohës vendeve anëtare të NATO-s gjithnjë për këtë angazhim historik dhe i obligohen NATO-s për kontributin madhor në rrugën lirishtetërore dhe shtet-ndërtuese të Kosovës.

Kështu që, NATO është pjesë e historisë modern të shqiptarëve. Por, kjo mirënjohje dhe dashuri ndaj NATO-s duhet të kultivohet më me kujdes dhe më me pasion në kuptim të vazhdimësisë edhe më tej, pa lejuar një rënie. Intervenimi i NATO-s në Kosovë në vitin 1999 ka qenë një fanar dhe njëkohësisht shtytës i procesit të integritetit të vendeve të rajonit në NATO duke ndikuar që vendet e rajonit ballkanik të binden në praktikë se si NATO-ja paraqet një garantues të sigurisë dhe se prandaj është tejet i vlefshme për këto vende orientimi dhe reformat për anëtarësim në NATO. Çdo gjë në kuptim të integritetit të vendeve ballkanike në NATO në esencë filloi nga intervenimi i NATO-s në Kosovë në vitin 1999. (Latifi, 2022)

Roli i OKB-së në pavarësinë e Kosovës

Organizata e Kombeve të Bashkuara është përafërsisht si një qeveri botërore, por nuk është qeveri botërore. Të gjitha anëtarët e OKB-së janë shtete sovrane të cilat nuk i kanë dhënë fuqi OKB-së për një vullnet të detyrueshëm brenda territoreve të shteteve anëtare, përveç nëse e marrin pëlqimin e qeverive të shteteve të tyre. Qëllimi kryesor i OKB-së është të ofrojë një mënyrë organizimi institucional botëror ku shtetet do të mund të përdorin më pak dhunën e më shumë mënyrën paqësore të zgjedhjes së konflikteve. Si organizata ndërkombëtare universale janë p.sh.: Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), UNICEF-i, UNHCR, etj. Me themelimin e UNMIK-ut, konstatohet se për herë të parë në historinë e saj, OKB-ja mori përsipër zbatimin e një mandati të paprecedentë, si për nga numri dhe larmia e kompetencave, ashtu edhe për nga struktura e komplikuar e funksionimit, për të ndër-tuar një territor të shkatërruar nga konflikti i armatosur, populli i të cilit haptazi kërkonte pavarësi. OKB-ja dha mundësinë e saj për të testuar dhe dëshmuar aftësinë e kësaj organizate për të përballuar në terren sfidat në rivendosjen e paqes, sigurisë, qeverisjes së mirë dhe zhvillimit të shoqërisë të shpartalluar prej konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjetkë. Një mision i tillë ishte plotësisht në përputhje me qëllimet dhe parimet e Organizatës. Megjithatë, OKB-ja ishte e bindur se efektiviteti i UNMIK-ut në adresimin e sfidave për rindërtimin e Kosovës, varej në mënyrë të pashmangshme nga mbështetja e shpejtë dhe të fortë e Këshillit të Sigurimit dhe shteteve anëtare të OKB-së. (UNMIK, 1999). Në rastin e UNMIK-ut, organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare (në total ishin 4, OKB, OSBE, BE dhe NATO, por kjo e fundit vepronte në

kuadër të KFOR duke ofruar siguri në mbështetje të punës së UNMIK-ut, por nuk është në varësi të OKB-së) do të duhej të punonin së bashku për përmbushjen e një detyre të përbashkët dhe nën një udhëheqje. Asnjë prej këtyre aktorëve nuk do të mund të vepronte më vete. Vendosja e një administratë të përkohshme, sigurimi i ndihmave humanitare, ndërtimi i institucioneve demokratike dhe rivendosja e një ekonomie tregu funksionale, përbënte një ndërthurje çështjesh delikate që kapërcente mundësinë dhe ekspertizën profesionale të secilës prej këtyre organizatave të marra më vete.

Roli i BE-së në pavarësinë e Kosovës

Mund të themi se kemi dy faza të partneritetit në mes të BE-së dhe Kosovës. Faza e parë mund të quhet pas përfundimit të konfliktit e deri të shpallja e pavarësisë (1999-2008), dhe faza e dytë prej vitit 2008 pas shpalljes së pavarësisë, e deri më sot. Në këtë aspekt, që nga viti 1999, BE-ja ka luajtur dy role kryesore. Njëra lidhet me mbështetjen teknike dhe financiare, p.sh. investime të vazhdueshme në përkrahje të zhvillimit institucional dhe kapaciteteve të saj dhe miratimit të parimeve dhe rregullave të BE-së ku vetëm në kuadrin e IPA I, IPA II dhe instrumenteve të tjera të BE-së, nga 2007 në 2020, BE ka investuar në Kosovë më shumë se 1.5 miliarda € në rindërtim, reformë të administratës publike, sundim të ligjit, reformë të qëndrueshme ekonomike, arsim, bujqësi, sociale zhvillimi, shoqëria civile dhe media dhe në shumë fusha të tjera kyçe në Kosovë. Roli tjetër i BE-së në Kosovë lidhet me përkushtimin e BE-së për ruajtjen e stabilitetit, paqes dhe perspektivës Evropiane për Ballkanin Perëndimor. Me qëllim të zhvillimit të kësaj perspektive, BE-ja ka ofruar ndërmjetësim politik duke sjellë praktika dhe shembuj të mirë në Kosovë. Struktura qeverisëse pas luftës në Kosovë deri në shpalljen e pavarësisë, i ngjante një piramide, në majën e të cilës qëndronte rezoluta 1244. Gjatë viteve pasuese, UNMIK-u ka përkrahur realizimin e disa të arriturave në fushën e sundimit të ligjit. Procesi i transferimit të përgjegjësive nga UNMIK-u tek institucionet e zgjedhura filloi përafërsisht në të njëjtën kohë, por ishte mjaft i ngadalshëm. Roli mbikëqyrës i UNMIK-ut krijoi një kulturë të papërgjegjësive në mesin e elitës politike. UNMIK-u u ristrukturua në vitin 2008 dhe detyrat e tij ekzekutive në sundimin e ligjit u bartën tek Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

(EULEX), në pajtim me deklaratën e Kryetarit të Këshillit të Sigurimit më 26 nëntor 2008. (EULEX-Mision of EULEX, 2022)

Vendosja e EULEX-it

Çështja e statusit të pazgjidhur përbënte gjithnjë e më shumë një problem serioz për Kosovën. Dëshira për pavarësi përbënte për kosovarët shtysën kryesore për reformimin e vendit të tyre. Rruga drejt pavarësisë nënkuptonte për kosovarët gjithashtu edhe shumë kohë të dedikuara dhe energji të shpenzuar për zgjidhjen e çështjes së statusit. Artikulimi prej UNMIK-ut në fazat e hershme të administrimit prej tij të Kosovës të *status quo*-së, e maskuar më vonë me artikullimin e politikës së standardeve para statusit, pati një ndikim dekurajues për sa i përket motivimit të banorëve të Kosovës për të pranuar dhe zbatuar një seri të reformave të nevojshme për demokratizimin e shoqërisë kosovare. Për aq kohë sa statusi i Kosovës mbetej i papërcaktuar, minoriteti serb ushqente shpresa se Kosova një ditë do të kthehej nën sundimin serb. Këshilli i BE-së i avancoi planet e tij për praninë e misionit post-statusor, duke themeluar ekipet planifikuese në Kosovë për EULEX-in dhe Zyrën Civile Ndërkombëtare (ZCN) / Zyrën e Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE). NATO arriti në përfundim se ishte për lejimin dhe mbikëqyrjen e krijimit të një Force të Sigurisë së Kosovës, të vogël e të armatosur lehtë, dhe kjo u mor parasysh në Propozimin e ri të Ahtisarit. EULEX-i e ka ruajtur strukturën themelore të tij, d.m.th. dy sektorët kryesorë: “Ekzekutiv” dhe “Fuqizim”. Misioni i përgjithshëm i EULEX-it është t’i mbështesë institucionet përkatëse të sundimit të ligjit në Kosovë në rrugën e tyre drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë, shumë-etnicitetit dhe llogaridhënies, të lira nga ndërhyrjet politike dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikën më të mira evropiane. Mandati aktual i EULEX-it është filluar për ta mbuluar periudhën deri më 14 qershor 2023 duke u bazuar në Vendimin e Këshillit CFSP 2021/904. Në kuadër të mandatit të tij, Misioni zhvillon aktivitete të monitorimit dhe funksione ekzekutive të kufizuara. (Çështje EULEX-i?, <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,16>, 2022). Luftërat e fundit ballkanike e vërtetojnë faktin se historia e shqiptarëve tregon se ata janë mbase i vetmi popull në Gadishull që nuk njihen si pushtues, nuk është shkruar askund se ata kanë përgjakur fqinjët e tyre. Asnjëherë nuk kanë vuajtur prej ndjesisë hegjemoniste, nuk kanë hartuar strategji apo programe të posaçme për

zaptime tokash të huaja. Shqiptarët historikisht kanë qenë të pushtuar. Ndoshta kjo ishte arsyeja se pse NATO-ja ju gjend pranë shqiptarëve, që të mos përsëritej tragjedia e Bosnjës. (Arben Kondi, 2003).

Kosova është anëtare e këtyre organizatave ndërkombëtare:

- Banka Botërore
- Fondi Monetar Ndërkombëtar
- Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim
- Federata Botërore e Futbollit
- Federata Evropiane e Futbollit
- Komiteti Olimpik
- Organizata Botërore e Doganave
- Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA).

Ndërsa nuk është anëtare e këtyre organizatave:

- Organizatës së Kombeve të Bashkuara
- Bashkimit Evropian
- Këshillit të Evropës
- Organizatës Botërore të Tregtisë
- Organizatës Botërore të Shëndetësisë
- Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.
- Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL)
- Agjencinë për Arsim, Shkencë dhe Kulturë të Kombeve të Bashkuara (UNESCO). (Krasniqi-Veseli, 2020)

Conclusion

The EU is open to every European country that respects the principles of freedom, democracy, basic human rights and freedoms, and the rule of law. The EU has long been heavily engaged in the region. Since then, the European perspective of the region has helped countries achieve comprehensive political and economic reforms with improved democratic processes. Visa liberalization and improved regional cooperation foster more transparent societies. The future of the EU is closely interdependent with the future of the Balkans. The more active involvement of senior EU officials seems somewhat impossible as long as five EU member states do not recognize Kosovo. The complete normalization of relations between Kosovo and Serbia is a key issue for the future of the Western Balkans, both for the political stability of the

region, as well as for further socio-economic development. The alignment of Kosovo and Serbia with EU requirements and standards will go through a transition process, which in the first steps will be based on the normalization of relations between Kosovo and Serbia, followed later by their full inter-state cooperation at bilateral and multilateral levels, as two normal independent and neighboring states.

Minority communities in Kosovo enjoy unparalleled rights in Europe and beyond. Serbia always plays the role of the unsatisfied and the impression is often created that as long as Kosovo exists in any form, it will be unsatisfied even though for many acts of crime and genocide it is still not punished by adequate institutions. Accession is and will remain a merit-based process that is entirely dependent on the objective progress achieved by each country. Countries should match or surpass each other in achievement depending on the progress made. We are all witnesses of the many efforts that are being made by the High Representative of the European Union, Josep Borrell, to reach an agreement between Kosovo and Serbia, or as it is said an agreement on license plates, which is rightly considered the current situation created as the most crisis serious in the last ten years. It remains to be seen the future processes between states that are in dispute, which are key points for the stabilization of the region in general.

Recensentë:

Prof. Dr. Drita M. Fazlia

Prof. Dr. Bashkim Selmani

Referencat:

[1.] Arben Kondi. (2003). Barbarët. In A. Kondi, Barbarët (p. 36). Tiranë.

[2.] Bislimi, E. (2010, November). Lufta dhe Inter lufta dhe Intervenimi i NATO-s në Kosovë,. Prishtinë, Republic of Kosovo.

[3.] Çështë EULEX-i?, <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,16> . (2022). Retrieved November 20, 2022, from EULEX: <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,16>, vizituar me datë 23.11.2022

[4.] Dalipi, F. (2022).

https://www.academia.edu/33121674/ORGANIZATAT_ND%C3%8BRKOMB%C3%8BTARE_Pjesa_I_par%C3%AB, . Retrieved November 30.11.2022, 2022, from Academia.

- [5.] Enika Abazi. (2015.). Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm. Tiranë.
- [6.] EULEX-Mision of EULEX. (2022). Retrieved November 20, 2022, from [https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,16,Eulex-Unioni European](https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,16,Eulex-Unioni%20European), vizituar me datë 23.11.2022: <https://www.eulex-kosovo.eu>
- [7.] Gashi, S. (2006). Mendimet e Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë. Prishtinë.
- [8.] Gruda, Z. (2003). E drejta ndërkombëtare Publike. Prishtinë.
- [9.] Krasniqi-Veseli, L. (2020, June). /ja/ne-cilat-organizata-u-anetaresua-kosova-/30676253.html, . Retrieved November 22, 2022, from Evropa e lirë: <https://www.evropaelire.org>
- [10.] Latifi, V. (2022, June). Intervenimi i NATO-s në luftën e Kosovës dhe shënimi i një kaptine të re të sigurisë ndërkombëtare për Ballkanin. Prishtinë, Republic of Kosovo.
- [11.] Puto, A. (2004). E drejta Ndërkombëtare Publike,. In E drejta Ndërkombëtare Publike, (p. 209). Tiranë, Republika e Shqipërisë: Albin.
- [12.] Qirko, Q. (2017, June). Ballkani Perëndimor perspektivat integrale dhe sfidat. London, UK, UK.
- [13.] UNMIK. (1999, June). <https://unmik.unmissions.org/sq/rezoluta-1244-e-kombeve-t%C3%AB-bashkuara>,. Retrieved 2022, from UNMIK: <https://unmik.unmissions.org>
- [14.] Watch, H. R. (2002). Nën pushtetin e urdhërave, Krimet e luftës në Kosovë . In H. R. Watch, Nën pushtetin e urdhërave, Krimet e luftës në Kosovë. New York,, Washington, Brusels